

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË**

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. Q-28090 / prot.

Tiranë, më 18 / 12 / 2022

Lënda: Kthim përgjigje

✓ **QENDRËS "RES PUBLICA"**

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-28090 datë 01.12.2022 dhe ka kaluar për shqyrtim te Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, e cila ka kthyer përgjigje si më poshtë vijon:

"Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me anë të së cilës keni kërkuar kopje të projektit dhe kopje të kontratës midis palëve, Bashkia Tiranë dhe shoqërive: "Atelier 4" sh.p.k, "Kejsi 05" sh.p.k dhe "Seed Consulting" sh.p.k, me objekt "Rikualifikim urban i sheshit "Garibaldi" dhe hapësirave përreth tij", bazuar në tenderin me numër reference REF-72654-09-22-2020".

Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se projekti është hartuar bazuar në PdyV-në e miratuar për zonën zhvillimore Kombinat, në linkun më poshtë do gjeni të plotë PdyV-në.

<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6698&token=ff4aeaf967201d46c536b278df8725523ecb07f4>

Detaje të projektit nuk mund t'ju vihen në dispozicion pasi ende nuk është prokuruar nga Autoriteti Kontraktor. Ndërsa lidhur me kërkesën tuaj në pikën nr.2, po ju informojmë se të dhënat e kontratës janë të publikuara në Buletinin e Posaçëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, i cili është i aksesueshëm nga çdo person i interesuar".

Lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT


Blerta Goxha